

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

Përgjegjës i Sektorit të Numeracionit, Sigurisë së Rrjeteve, Infrastrukturës dhe IT

Procedura: NGRITJE NË DETYRË

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM-së nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Z. Fjorald Bitri** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e ngritjes në detyrë.

Konkurimi:

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **06.04.2021 ora 11:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **06.04.2021 ora 13:00**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **20** pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. **40** pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. **40** pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Përgjegjës i Sektorit të Numeracionit, Sigurisë së Rrjeteve, Infrastrukturës dhe IT**.

Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **06.04.2021**.

Njoftimi fituesit do të publikohet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **12.04.2021**.

Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)